



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-30793/22
Kaçanik, 30.11.2022

Në bazë të nenit 12.2(d) lidhur me nenin 40.2 (c) dhe (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës 01Nr. 6/01-12895/20 të datës 30.06.2020, të nenit 15.1(c) lidhur me nenin 55 të Rregullores 01Nr. 7864/08 për Punë të Kuvendit të Komunës të datës 13.11.2008, të Propozim Vendimit të Kryesuesi i Kuvendit prej datës 16.11.2022, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 Nëntor 2022, mori këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË
KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023

1. Me këtë Vendim, formohet Komisioni për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023, në përbërje prej 5 anëtarëve, 4 anëtarë do të jenë nga Kuvendi i Komunës dhe 1 anëtar nga Zyra e Kryetarit të Komunës, si vijon:

1.1.	Kemal Murseli,	kryesues	nga KK
1.2.	Fatmir Bunjaku	anëtar	nga KK
1.3.	Agim Mani	anëtar	nga KK
1.4.	Arlinda Rakoci-Raka	anëtar	nga KK
1.5.	Makfire Malsiu	anëtar	nga Zyra e Kryetarit.

2. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi do të hartoj Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023 dhe për të njëjtin do t'i zhvilloj procedurat e nevojshme sipas rregullave ligjore në fuqi deri me miratimin e planit nga Kuvendi i Komunës.

3. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 –Për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e komisionit, Kryetari i Komunës dhe Arkivi.

